



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN

02 Nr. / Br 34/24

Nr. i fq. / Br. st _____

Data: / Datum 17.01.2024

VUSHTRRI - VUČITRN



KOMUNA VUSHTRRI

KËSHILLI I BASHKËSISË ISLAME VUSHTRRI

Bazuar në nenin 5, dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28, 04 Qershor 2008), nenin 13 dhe 44 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe duke pasë parasyshë interesin e përbashkët të Komunës së Vushtrrisë dhe Këshillit të Bashkësisë Islame në Vushtrri, palët:

- Komuna e Vushtrrisë përfaqësuar nga z. **Ferit Idrizi**, Kryetar i Komunës (këtu e tutje, Komuna)
- dhe
- Këshilli i Bashkësisë Islame Vushtrri (KBI), përfaqësuar nga z. **Shemsi Rrahimi**, Kryetar (këtu e tutje, Bashkësia Islame), lidhin këtë:

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI PËR FINANCIM TË PËRBASHKËT

Neni 1 Qëllimi

1.1 Qëllimi i lidhjes së kësaj marrëveshje është financimi i përbashkët i projektit për themelimin e portalit të Këshillit të Bashkësisë Islame në Vushtrri i cili do të jetë në shërbim të qytetarëve si dhe për të krijuar softwer për rastet e vdekjeve përkatësisht mbajtjen e të dhënave në softwer, për të pasë një pasqyrë të saktë Bashkësia Islame në Vushtrri si dhe Komuna- Zyra e gjendjes civile.

1.2 Portali gjithashtu parashev që të përfshijë edhe pjesën kulturore të qytetit tonë, e cila ka një rëndësi të veçantë, respektivisht historikun e objekteve fetare islame. Më saktë të jetë një lloj guide e kulturës fetare për komunën tonë.

Neni 2 Vlera e projektit dhe financimi

2.1 Vlera e përgjithshme e projektit nga neni paraprak i kësaj marrëveshje është 39,000.00 € (tridhjetë e nëntëmijë euro).

2.2 Këshilli i Bashkësisë Islame Vushtrri financon këtë projekt me 51 % të vlerës së përgjithshme të projektit ose 19,890.00 € (nëntëmbëdhjetëmijë e tetëqind e nëntëdhjetë euro),

2.3 Komuna e Vushtrisë financon nga buxheti i saj në këtë projekt me 49 % ose 19,110.00 € (nëntëmbëdhjetëmijë e njëqind e dhjetë euro).

2.4 Këto mjete do të i transferohen në llogarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame Vushtrri, në muajin janar të vitit 2024.

Neni 3 Obligimet e komunës

3.1 Komuna e Vushtrisë i zoton mjetet për projektin nga kjo marrëveshje dhe një kopje të dokumentit me të cilin dëshmohet se janë zotuar mjetet e dërgon në KBI.

3.2 Komuna pas kryerjes së pagesës së mjeteve financiare nuk merr asnjë detyrim material për mirëmbajtje të portalit.

Neni 4 Obligimet e Këshillit i Bashkësisë Islame

4.1 KBI siguron mjetet nga nen 2 pika 2.2 i kësaj Marrëveshje dhe një kopje të dokumentit mbi sigurimin e mjeteve e dërgon në Komunë.

4.2 KBI obligohet që të gjithë certifikatat e vdekjes, të cilat në baza mujore i dërgon në komunë, t'i plotësojë edhe me dëshminë mjekësore për vdekjen. Në bazë të kësaj, Komuna do të bëjë Regjistrimin e faktit të vdekjes - çregjistrimin e të vdekurve dhe se familjarët më nuk detyrohen ta bëjnë Regjistrimin e faktit të vdekjes - çregjistrimin.

4.3. KBI Obligohet që brenda dyzetë e tetë (48) orëve nga varrosja e personit të njoftojë zyrën e gjendjes civile për varrmin e kryer, duke (bashkangjitur) prezantuar, raportin mjekësor për konstatimin e vdekjes dhe kopjen e letërnjoftimit për të vdekurin.

Neni 5 Kohëzgjatja

Kjo marrëveshje mirëkuptimi lidhet për kohë të pacaktuar.

Neni 6 Mbikëqyrja e zbatimit marrëveshjes

5.1 Komuna, nga ana e saj do të bëjë mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj marrëveshje përmes zyrtarit kompetent të Drejtorisë për Administratë – Zyra e Gjendjes Civile.

5.2 KBI obligohet që ti dërgoj komunës së Vushtrrisë raport mujor në fillim të çdo muaji lidhur me progresin e marrëveshjes.

Neni 7
Ndryshimet eventuale të marrëveshjes

Me pëlqimin paraprak të palëve nënshkruese kjo Marrëveshje e Mirëkuptimit mund të ndryshohet dhe plotësohet me aneks marrëveshje.

Neni 8
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve eventuale

Palët pajtohen që mosmarrëveshjet eventuale të i zgjidhin me mirëkuptim, në të kundërtën çështja do të kalohet në Gjykatën kompetente.

Nr. 9
Numri i ekzemplarëve

Marrëveshja e mirëkuptimit është përpiluar dhe nënshkruar në tre (3) ekzemplar identik në original, prej të cilëve dy (2) për komunën dhe një (1) për KBI.

Neni 10
Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje të hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Komuna e Vushtrrisë

F. Idrizi

z. Ferit Idrizi, Kryetar



KBI Vushtrri

S. Rrahimi

z. Shemsi Rrahimi, Kryetar

